UNIVERSITETI I PRISHTINËS
UNIVERSITAS STUDIORUM PRISHTINIENSIS

Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +381-38-244183 URL: http://www.uni-pr.edu
Fax: +381-38-244187 Mail: rektorati@uni-pr.edu

Universiteti i Prishtinës
shpall

KONKURS PLOTËSUES
PËR REGJISTRIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE, NË KONKURSIN PLOTËSUES, PËR VITIN AKADEMIK 2012-2013

Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve, në konkursin plotësues për vitin akademik **2012**-**2013,** do të regjistrojë **4023** studentë, prej të cilëve **2713** studentë të rregullt dhe **1310** studentë me korrespondencë.

Universiteti do të regjistrojë edhe **231** studentë të rregullt nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva e Bujanoci, si dhe **261** studentë nga minoritetet: boshnjakë, turq, romë, ashkali dhe egjiptianë.

Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.

Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i.

Kandidatët jokosovarë dhe minoritarë kanë të drejtë të konkurrojnë dhe të pranohen vetëm në kuotat e parapara për ta.

Kandidatë jokosovarë konsiderohen ata kandidatë që e kanë mbaruar shkollimin e mesëm jashtë Kosovës dhe me rastin e paraqitjes në konkurs, duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet e shkollimit.

Njohja (nostrifikimi) e diplomave bëhet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Secili kandidatë mund të konkurrojë vetëm në një fakultet, departament apo drejtim.

Kandidatët që refuzohen mund t'i paraqesin ankesë Këshillit të Fakultetit, të njëjtën ditë kur janë njoftuar për rezultatet e provimit pranues. Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Këshilli merr vendim për ankesën ditën e nesërme.

MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakulteteve përveç Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetit të Inxhinierisë Mekanik, Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetit të Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë, Fakultetit të Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë dhe Fakultetit të Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj, do të bëhet sipas këtyre kritereve:

A. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100:

- Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë dhe
- Suksesi në Provimit pranues deri në 80 pikë.

B. Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë,
- Suksesi në maturë deri në 50 pikë dhe
- Suksesi në provim pranues deri në 30 pikë.

Për Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanik, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë, Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë dhe Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj pranimi i kandidatëve do të bëhet sipas këtyre kritereve:

Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100
1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë
2. Suksesi në provim pranues deri në 80 pikë.

Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:

Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë.
1. Suksesi në shkollën e mesme deri në 20 pikë
2. Suksesi në maturë deri në 50 pikë
3. Suksesi në provimin e maturës nga lëndët me përparësi për regjistrim në fakultet deri në 30 pikë.

Lëndët me përparësi për regjistrim në fakultet janë të treguara në pjesën e konkursit ku bëhet fjalë për secilin prej këtyre fakulteteve.

Secila dëftesë e shkollës së mesme të lartë vlerësohet mbi bazën e suksesit maksimalisht me pesë pikë.

Për kandidatët nga pika 1. në provim pranues, prej 80 pikëve, 40 pikë mund të arrihen nga pjesa teorike dhe 40 pikë nga pjesa praktike.

Për kandidatët nga pika 2. në provim pranues, prej 30 pikë, 15 pikë mund të arrihen nga pjesa teorike dhe 15 pikë nga pjesa praktike.

Të drejtë radhitje përkatësish pranimi, sipas pikave A. dhe B. kanë vetëm kandidatët që arrijnë **30%** nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.

Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues më së shumti në tri lëndë mësimore, të cilat i caktojnë vetë fakultetet.

Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.

Nëse numri i pikëve te disa kandidatë është i barabartë, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të përgjithshëm nga shkolla e mesme. Nëse edhe pas kësaj do të kemi të njëjtën dukuri, merret suksesi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse dukuria e numrit të barabartë të pikëve përsëritet, zgjedhjen e kandidatëve (deri te numri i paraparë për regjistrim) do ta bëjë komisioni përkatës i fakultetit.

Fakultetet janë të obliguara që tërë ranglistën e kandidatëve të cilët kanë konkurruar t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në Ueb faqen e fakultetit.

Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës apo drejtimit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.

Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve datat e sendërtimit të konkursit janë si vijon:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës 17. 9 .2012 deri më 27. 9. 2012 në ora 16.00

Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente origjinale:

- Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (Linku) për aplikim Online përmes Internetit është: http://apliko.uni-pr.edu**

- Certifikatën e lindjes,
- Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme,
- Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës,
- Kopjen e lejes së njoftimit.
- Pagesën prej 10 €. Forma e pagesës shkarkohet dhe printohet nga Ueb faqja e Universitetit të Prishtinës ndërsa pagesa bëhet në bankë
- Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit
- Për kandidatët që konkurrojnë për tu regjistruar në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakultetin e Inxhinierisë Mekanik, Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakultetin e Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë, Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë dhe Fakultetin e Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj e që kanë mbaruar maturën paraqesin edhe Vërtetimin mbi pikat e arritura nga lëndët në provimin e maturës,
- Kandidatët që konkurrojnë për studime me korrespondencë duhet të sjellin edhe dëshminë që janë në marrëdhënie të rregullt pune(kontratën e punës ose një vërtetim),
- Shtetasit e huaj, që nuk e kanë mbaruar shkollimin e mesëm në gjuhën shqipe, përveç dokumenteve të lartcekura, paraqesin edhe dëshminë mbi njohjen e gjuhës shqipe.
- Paraqitja e dokumenteve për Fakultetin e Edukimit bëhet nëpër qendra.

2. Provimi pranues do të mbahet më 02. 10. 2012, në orën 9:00, përveç:

- Fakultetit Ekonomik ku Provimi pranues do të mbahet me 03.9.2012, në orën 9,00 në Prishtinë dhe
- Fakultetit Juridik Qendra në Gjilan ku Provimi pranues do të mbahet me 03.9.2012, në orën 9,00 në Qendren në Gjilan.

- Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta kenë me vete vetëm lejen e njoftimit pa të cilën nuk mund ti nënshtrohen provimit pranues dhe një mjet shkrimi.
- ***Ndalohet hyrja në provim pranues me telefon celular***.

3. Shpallja e rezultateve të provimit pranues do të bëhet deri më 05.10.2012.

Rezultatet e provimit pranues do të shpallën në Ueb faqet e fakulteteve përkatëse.

4. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet sipas fakulteteve prej 09. 10. 2012 deri më 15.10.2012, sipas këtij orari:

- Fakulteti Filozofik më **09. 8. 2012** prej orës **9:00 - 15:00** në Fakultetin Filozofik**,**
- Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore më **09. 8. 2012** prej orës **9:00 - 15:00**, në Amfiteatrin e Fizikës së FSHMN-së;
- Fakulteti i Filologjisë dhe Fakulteti i Shkencave Sportive më **09. 8. 2012** prej orës **9:00 - 15:00**, në Amfiteatrin e Fizikës së FSHMN-së;
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë **09. 8. 2012** prej orës **9:00 - 15:00** në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë
- Fakulteti Juridik Qendra në Prishtinë më **10. 10. 2012** prej orës **9:00 - 15:00,** në Amfiteatrin e Fakultetit Juridik;
- Fakulteti Ekonomik Qendra në Prishtinë më **10. 10. 2012,** prej orës **9:00 -15:00** në Amfiteatrin e Fakultetit Juridik;

- Fakulteti i Edukimit Qendra në Prishtinë më **10. 10. 2012,** prej orës **9:00 -15:00** në Amfiteatrin e Fakultetit Juridik;

- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Fakulteti i Mjekësisë më **11. 10. 2012,** prej orës **9:00 -15:00** në Fakultetet teknike;

- Fakulteti i Arteve më **12.10. 2012** prej orës **9:00 - 15:00,** në Fakultetin e Arteve

- Fakulteti Juridik Qendra në Gjilan, Fakulteti Ekonomik Qendra në Gjilan dhe Fakulteti i Edukimit Qendra në Gjilan, më **11. 10. 2012,** prej orës **10:00 -14:00** në Fakultetin e Edukimit në Gjilan.

- Fakulteti i Gjeoshkencave dhe Teknologjisë në Mitrovicë dhe Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë më **12.10. 2012,** prej orës **10:00 -14:00** në Fakultetet përkatëse.

- Fakulteti i Filologjisë Qendra në Gjakovë, Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore Qendra në Gjakovë, Fakulteti i Mjekësisë Qendra në Gjakovë dhe Fakulteti i Edukimit Qendra në Gjakovë, më **15 .10 2012,** prej orës **10:00 -14:00** në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë.

- Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj më **15.10. 2012,** prej orës **10:00 - 14:00** në FSHTA në Ferizaj.

Regjistrim të kandidatëve jashtë këtyre afateve nuk do të ketë, prandaj luten kandidatët e pranuar që t'i përmbahen afatit të lartcekur.

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

1. Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,
2. Tri fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
3. Pagesa për një semestër në lartësi prej **50 €** për studime të rregullta**,** respektivisht **250€** për studime me korrespondencë.

Pagesa bëhet në njërën prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe printohet nga Ueb faqja Universitetit të Prishtinës.

Njoftimet dhe programet për provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse.

Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

Në departamentet, degët dhe drejtimet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkursi plotësues.

Për informata më të hollësishme kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose të hapin faqen e internetit: **www.uni-pr.edu**

I. FAKULTETI FILOZOFIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **299** studentë, prej të cilëve **70** të rregullt dhe **229** me korrespondencë:

Departamenti	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Departamenti i Filozofisë	**42**	**29**
Departamenti i Pedagogjisë-Drejtimi Pedagogji e Përgjithshme		**37**
Departamenti i Punës sociale		**-**
Departamenti i Historisë		**47**
Departamenti i Shkencave Politike		**41**
Departamenti i Sociologjisë		**37**
Departamenti i Psikologjisë		**38**
Departamenti i Etnologjisë me Antropologji Kulturore	**28**	**-**

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Pedagogjisë nga Edukata qytetare, Psikologjia dhe Filozofia;
- Në Departamentin e Historisë nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukatë qytetare
- Në Departamentin e Shkencave Politike nga Sociologjia, Filozofia dhe Edukata qytetare.
- Në Departamentin e Sociologjisë nga Sociologjia dhe Filozofia.
- Në Departamentin e Etnologjisë me Antropologji Kulturore nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.
- Në Departamentin e Psikologjisë nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE - PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **310** studentë të rregullt, dhe atë:

Departamenti i Matematikës	**19**
Drejtimi Arsimor	19
Departamenti i Fizikës	**81**
Drejtimi Arsimor	39
Drejtimi Inxhinierik	42
Departamenti i Kimisë	**96**
Drejtimi Arsimor	57
Drejtimi Inxhinierik	39
Departamenti i Biologjisë	**57**
Drejtimi Arsimor	24
Drejtimi Ekologji-Mbrojtje e ambientit	33
Departamenti i Gjeografisë	**24**
Drejtimi Aplikativ	24
Qendra në Gjakovë	**33**
Drejtimi Kimi Arsimore	33

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

Për Departamentin e Matematikës: Matematikë, Fizikë dhe Informatikë
Për Departamentin e Fizikës: Fizikë, Matematikë, Informatikë
Për Departamentin e Kimisë: Kimi, Matematikë, Fizikë
Për departamentin e Biologjisë: Biologji, Kimi, Fizikë
Për Departamentin e Gjeografisë: Gjeografi, Matematikë, Informatikë.

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa provim të maturës, provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës nga Fizika;
- Në Departamentin e Kimisë nga Kimia dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë nga Gjeografia.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **264** studentë, prej të cilëve **159** të rregullt dhe **105** me korrespondencë dhe atë:

Dega	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Dega e Gjuhës Shqipe	15	19
Dega e Letërsisë Shqipe	49	19
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze		14
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane		14
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge	31	19
Dega e Orientalistikës	26	10
Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Turke	29	10
Qendra në Gjakovë	**9**	**-**
Dega e Gjuhës Shqipe	9	-

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Në Degën e Gjuhës Shqipe nga Gjuha shqipe (me shkrim**);**
- Në Degën e Letërsisë Shqipe nga Letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze nga Gjuha angleze (me shkrim);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nga Gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge nga Gjuha frënge (me gojë);
- Në Degën e Orientalistikës nga Gjuha arabe (me gojë);
- Në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nga Gjuha turke (me gojë);
- Në Degën e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga lëmenjtë: Gjuhë shqipe, Letërsi shqipe, Qytetërim shqiptar, Qytetërim botëror dhe Ese.

IV. FAKULTETI JURIDIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **466** studentë me korrespondencë dhe atë:

Qendra	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Qendra në Prishtinë		**327**
Qendra në Gjilan		**139**

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe.

V. FAKULTETI EKONOMIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **639** studentë, prej të cilëve **129** të rregullt dhe **510** me korrespondencë dhe atë:

Qendra	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë
Qendra në Prishtinë		**391**
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet		117
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë		113
Departamenti Marketing		81
Departamenti Ekonomiks		80

Qendra në Gjilan	**129**	**119**
Departamenti Financa, Banka dhe Kontabilitet	104	59
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë	25	60

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë.

VI. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **16** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Ndërtimtarisë	**16**
Drejtimi Hidroteknik	16

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga Matematika, ndërsa në Departamentin e Arkitekturës edhe nga Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë(sllajdi).

Për tu ranguar kandidati duhet të arrijë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **112** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Elektronikës	24
Departamenti i Automatikës	49
Departamenti i Elektroenergjetikës Industriale	39

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

Matematikë
Fizikë
Gjuhë shqipe

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa Provim të maturës, Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **517** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Prodhimtarisë dhe Automatizimit	137
Departamenti i Termoteknikës dhe Termoenergjetikës	130
Departamenti i Konstruktimit dhe Disajnimit	135
Departamenti i Komunikacionit	115

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

Matematikë
Fizikë
Informatikë

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa Provim të maturës, Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **152** studentë të rregullt dhe atë:

Qendra në Prishtinë	**112**
Dega e Fizioterapisë	22
Dega e Infermierisë	42
Dega e Mamisë	48
Dega në Gjakovë	**40**
Dega e Infermierisë	20
Dega e Mamisë	20

PROVIMI PRANUES

- Provimi pranues për të gjitha degët e Fakultetit të Mjekësisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

X. FAKULTETI I ARTEVE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **71** studentë të rregullt dhe atë:

Dega e Artit Figurativ	**19**
Drejtimi i Skulpturës	4
Drejtimi i Grafikës	3
Drejtimi i Skenografisë	2
Drejtimi Arti konceptual dhe mediet e reja	10
Dega e Artit Muzikor	**45**
Komponim	1
Dirigjim	2
Drejtimi i Instrumenteve Harkore	*7*
Violë	2
Violonçeli	2
Kontrabas	1
Harfa	*1*
Kitarë	*1*
Drejtimi i Instrumenteve me të Fryer	*14*
Flaut	1
Saksafon	2
Trompetë	1
Trombon	2
Tube	1
Fagot	2
Obo	1
Perkusion	2
Korna	2
Pedagogji e Përgjithshme Muzikore	21
Dega e Artit Dramatik	**7**
Drejtimi Aktrim	2
Drejtimi Dramaturgji	3
Drejtimi Regji teatri	2

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t' i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEGËN E ARTIT FIGURATIV

Për përcaktimin e talentit për krijimtari artistike, kushtet e veçanta për studim në Degën e Artit Figurativ janë:

Drejtimi i Pikturës

- 5 punime të punuara sipas modelit (studimi i kokës dhe figura në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj).

Drejtimi i Skulpturës

- së paku 5 punime nga skulptura sipas modelit, prej të cilave një duhet të jetë studimi i kokës në përpjesëtime natyrore dhe së paku 5 vizatime sipas modelit.

Drejtimi i Grafikës

- së paku 5 punime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj.).

Drejtimi i Dizajnit Grafik

- së paku 5 vizatime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore), si dhe 5 punime nga dizajni grafik (ilustrime, kopertona të librit, ambalazhe etj.).

Drejtimi i Skenografisë

- 10 projekte (skenografi), skica të skenografisë për dramë të caktuar, një skenografi të inskenuar në hapësirë të caktuar.

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Drejtimin e Pikturës dhe në Drejtimin e Grafikës: vizatim i kokës sipas modelit të gjallë (2 ditë), vizatim i aktit (2 ditë) dhe pikturim i natyrës së qetë (1 ditë).

Kandidatët punojnë me material të tyre.

- Në Drejtimin e Skulpturës: modeli i kokës sipas modelit të gjallë (3 ditë), vizatim i aktit (2 ditë).

- Në Drejtimin e Dizajnit Grafik: vizatimi i kokës sipas modelit të gjallë (2 ditë), vizatimi i aktit (2 ditë) dhe dizajn grafik (2 ditë). Kandidatët i nënshtrohen testimit nga njohja e përdorimit të kompjuterit.

Në të gjitha drejtimet e Degës së Artit Figurativ, do të organizohet interviste gojore apo me shkrim lidhur me njohuritë mbi profesionin që do të studiojnë.

Drejtimi Arti konceptual dhe mediet e reja

Faza e parë

- Kandidatët që konkurrojnë në Drejtimin e artit konceptual dhe mediet e reja duhet të sjellin një portofolio me 10 punime nga mediumet e reja.
- Kandidatët i shtrohet testit të përbërë prej 10 pyetjeve nga mediumet e reja në artet bashkëkohore.

Faza e dytë

- Kandidatët që kalojnë fazën e parë i nënshtrohen pjesë së dytë në të cilën fazë punohet një ese prej së paku 400 fjalë. Tema caktohet aty për aty.

Faza e tretë

- Puna praktike në mediumin që e zgjedh vetë kandidati:

1. Video
2. Video instilacion,
3. Pikturë konceptuale
4. Skulpturë konceptuale – instilacion etj.

NË DEGËN E ARTIT MUZIKOR

Kandidatët i shtrohen provimit pranues si vijon:

Në Drejtimin e Kompozimit:

- vlerësimi i 3 kompozimeve të dorëzuara, provimi nga lëndët Solfezh, Harmonia, Polifonia dhe Pianoja.

Në drejtimet instrumentale

- provimi nga lëndët kryesore (një koncert, një sonatë dhe një pjesë e lirë për drejtimet e harkorëve dhe frymorëve, kurse për drejtimin e pianos një etidë, pjesa nga Baroku, sonatë dhe pjesë e lirë) si dhe provim nga lëndët: Solfezh dhe Teoria e muzikës.

- Në Drejtimin Perkusione provimi nga lëndët Solfezh dhe Teori e muzikës.

NË DEGËN E ARTIT DRAMATIK

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Drejtimi Aktrim:

Programi eliminues, pjesa e parë përbëhet nga:

a) Recitim (sipas zgjedhjes së kandidatit);
b) Monolog (sipas zgjedhjes së kandidatit);
c) Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
d) Një këngë;
e) Një imitim;
f) Një poezi.

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues përbëhet nga: puna me mësimdhënës të caktuar, hartimi i detyrës me shkrim dhe verifikimi përfundimtar i aftësive**.**

Drejtimi Regji Teatri Filmi

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike.

Provimi pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situate nga një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Drejtimi Regji Filmi

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t' i shtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë, film tre minutash.

Drejtimi Dramaturgji:

Hartim me shkrim në temën e lirë,
Dialogu me shkrim në temën e tragjedisë,
Dialogu me shkrim në temën e komedisë,
Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga sfera e kulturës së përgjithshme,
Testim me gojë nga fusha e dramaturgjisë**.**

Literatura për provim pranues:

1. Aristoteli: "Poetika"
2. Vlladan Shvacov: "Bazat e dramaturgjisë"
3. Dr. Nebi Islami: "Historia e dramës kombëtare 1886-1996"
4. Dr. Josif Papagjoni: "Komedi që vjen nga skena"

5. Eskili: “Orestia”
6. Sofokli: Një tragjedi
7. Aristofani: Një komedi
8. Shekspiri: Një tragjedi
9. Molieri: Një komedi
10. Dramaturgji nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
11. Dramaturgji bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasëm Terbeshina etj.

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **284** studentë të rregullt dhe atë:

Drejtimi Prodhimtari bimore	168
Drejtimi menaxhimi i biznesit në zooteknikë	69
Drejtimi i Veterinarisë	47

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

Biologji
Kimi
Ndërmarrësi(ekonomi).

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa Provim të maturës, Provimi pranues për Drejtimet e Bujqësisë do të mbahet nga lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë, kurse për Drejtimin e Veterinarisë do të mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

XII. FAKULTETI I GJEOSHKENCAVE DHE TEKNOLOGJISË-MITROVICË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **252** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Xehetarisë	**52**
Departamenti i Gjeologjisë	**50**
Departamenti i Teknologjisë	**93**
Drejtimet e tjera(Mbrojtja e ambientit, Inxhinieria kimike)	57
Drejtimi Inxhinieria Ushqimore	36
Departamenti për Materiale dhe Metalurgji	**57**

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

- Për Departamentin e Xehetarisë, Gjeologjisë dhe Metalurgjisë: Matematika, Fizika dhe Kimia.

- Për Departamentin e Teknologjisë: Matematika, Biologjia dhe Kimia.

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa Provim të maturës, Provimi pranues do të mbahet nga lëndët:

- Për Departamentin e Xehetarisë : Matematikë,
- Për Departamentin e Gjeologjisë: Matematikë,
- Për Departamentin e Teknologjisë:
- Drejtime tjera: Matematikë
- Drejtimi Inxhinieri Ushqimore: Biologjia, Matematika,
- Për Departamentin e Metalurgjisë: Matematikë,

XIII. FAKULTETI I SHKENCAVE SPORTIVE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **78** studentë të rregullt (**44** meshkuj dhe **34** femra)

PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

1. Gjendja Psiko-Somatike (verifikimi shëndetësor, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor).
2. Not
3. Aftësitë lëvizore (motorike):
   - Kërcimi nga vendi në gjatësi,
   - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt),
   - Përkulje mbi krah (femrat),
   - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit- meshkujt dhe femrat),
   - Qëndrueshmëria në 1000 m(meshkujt) dhe 800 m (femrat) - matet koha e vrapimit,
   - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor),
   - Ndjeshmëria ritmike.
4. Njohuritë lëvizore(motorike) sportive:
   - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë
   - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë
   - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh.
   - Volejboll: pasimi i topit në çifte me gishta dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
5. Gjimnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).

   Paralele: mbështetje mbi krah, me lëkundje ngritje-para, dalje me trup të shtrirë prapa.

   Kandidatët janë të obliguar që në provim të kenë pajisjet sportive.

XIV. FAKULTETI I EDUKIMIT- PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **120** studentë të rregullt dhe atë:

Qendra	Për studime të rregullta
Qendra në Prishtinë	**40**
Programi i arsimit fillor	20
Programi parashkollor	20
Qendra në Gjilan	**40**
Programi i arsimit fillor	20
Programi parashkollor	20
Qendra në Gjakovë	**40**
Programi i arsimit fillor	20
Programi parashkollor	*20*

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për Programin e arsimit fillor dhe Programin parashkollor do të mbahet nga lëndët: Gjuhë shqipe, Matematikë dhe testi i të lexuarit të kuptimshëm.

Provimi është me shkrim.

XVII. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE TË APLIKUARA NË MITROVICË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **323** të rregullt dhe atë:

Departamenti i Informatikës Inxhinierike	184
Departamenti i Makinerisë Industriale	139

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

Matematikë
Fizikë
Informatikë

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa Provim të maturës, Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

XVII. FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE TË APLIKUARA FERIZAJ

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **120** studentë të rregullt dhe atë:

Departamenti i Makinerisë	**44**
Profili teknika e përpunimit të materialeve artificiale(Plastmasava)	44
Departamenti i Dizajnit dhe Teknologjia e drurit	**45**
Dizajni në interier dhe Teknologjia e drurit	45
Departamenti i Menaxhmentit Industrial	**31**
Menaxhmenti Industrial	31

Lëndët me përparësi nga provimi i maturës suksesi i të cilave do të merret para sysh për pranim janë:

Matematikë
Fizikë
Informatikë

PROVIMI PRANUES

Për kandidatët që kanë mbaruar shkollën e mesme pa Provim të maturës, Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

Universiteti i Prishtinës do të pranojë edhe **231** studentë nga Presheva, Bujanoci,Mali i Zi,Shqipëria dhe Maqedonia dhe atë:

	Fakulteti-Departamenti,Drejtimi	**Preshevë**	**Bujanoc**	**Mali I Zi**	**Shqipëri**	**Maqedoni**	**Gjithsej**
1	**Filozofik**	**11**	**14**	**1**	**2**	**2**	**30**
Departamenti	Filozofi	6	4	1	1	1	13
	Histori	4	3				7
	Shkenca politike	0	0		1	1	2
	Psikologji		4				4
	Sosiologji	1	3				4
2	**i Shkencave Matematiko-Natyrore**	**24**	**19**	**2**	**2**	**2**	**49**
Departamenti	i Matematikës-Arsimore	10	8	1	1	1	21
	Fizikë-Arsimore	3	3				6
	i Kimisë-Arsimore	4	2		1		7
	i Biologjisë-Arsimore	6	4	1			11
	i Gjeografisë-Arsimore	1	2			1	4
3	**i Filologjisë**	**3**	**5**	**4**	**2**	**1**	**15**
Departamenti	Gjuhë shqipe	1		1			2

	Letërsi shqipe			1			1
	Gj. dhe letërsi angleze	1	5		1		7
	Gj. dhe letërsi gjermane	1					1
	Gj. dhe letërsi frënge				1	1	2
	Orientalistikë			1			1
	Gazetari			1			1
4	**Juridik**	**1**	**3**	**1**	**1**	**2**	**8**
	Qendra në Prishtinë	1	3			1	5
	Qendra në Gjilan			1	1	1	3
5	**Ekonomik**		**1**	**2**	**4**	**1**	**8**
	Qendra ne Prishtinë		**1**		**2**	**1**	**4**
	Financa, banka dhe kontabilitet		1			1	2
	Qendra ne Gjilan			**2**	**2**	**0**	**4**
Departamenti	Financa, banka dhe kontabilitet			1	1		2
	Menaxhment dhe informatikë			1	1		2
6	**i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës**	**8**	**6**		**2**	**1**	**17**
Drejtimi	**Departamenti i Ndërtimtarisë**	**5**	**4**		**1**	**0**	**10**
	Konstruktiv	1	2				3
	Hidroteknik				1		1
	i Gjeodezisë	4	2				6
	Departamenti i Arkitekturës	**3**	**2**		**1**	**1**	**7**
7	**i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike**	**6**	**5**		**1**	**2**	**14**
Departamenti	i Telekomunikacioni					1	1
	i Elektronikës	3	2		1	1	7
	i Automatikës	3	3				6
8	**i Inxhinierisë Mekanike**	**3**	**3**	**0**	**0**	**0**	**6**
Departamenti	i Prodhimtarisë dhe Automatizimit	3	3				6
9	**i Mjekësisë**	**11**	**10**	**6**	**6**	**5**	**38**
Dega	Mjekësia e Përgjithshme		3	1	1		5
	Stomatologjia	2	1	1	1	1	6
	Farmaci	3	2	1	1	1	8
	Fizioterapia			1	1	1	3
	Infermieria	3	2	1	1	1	8
	Mami	3	2	1	1	1	8
10	**i Arteve**	**4**	**4**	**1**	**1**	**2**	**12**
Dega	**Arti Figurativ**	**4**	**4**	**0**	**0**	**0**	**8**
	Pikturë	1	1				2
	Skulpturë	1	1				2
	Grafikë	1	1				2
	Dizajn Grafik	1	1				2
	Arti Muzikor					**1**	**1**
	Arti Dramatik			**1**	**1**	**1**	**3**
11	**i Bujqësisë dhe Veterinarisë**	**4**	**3**	**2**	**2**	**2**	**13**
	Drejtimet e Bujqësisë	4	3	1	1	1	10
	Agroekonomi	4	3				7
	Drejtimi i Veterinarisë			1	1	1	3
13	**i Shkencave Sportive**			**2**	**2**	**2**	**6**
	Meshkuj			1	1	1	**3**
	Femra			1	1	1	**3**

14	**i Edukimit**		**4**	**0**		**0**	**4**
	Qendra në Prishtinë		**4**				**4**
	Programi i arsimit fillor		4				4
	Qendra në Gjakovë			**0**		**0**	
	Programi parashkollor						
17	**i Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë**		**0**	**2**	**0**	**0**	**2**
Departamenti	Informatikë Inxhinierike			1			**1**
	i Makinerisë Industriale			1			**1**
21	**i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj**		**0**	**3**	**3**	**3**	**9**
Departamenti	i Makinerisë			2	1	2	**5**
	Përpunimi i drurit			1	2	1	**4**
	Gjithsej	**75**	**77**	**26**	**28**	**25**	**231**

Universiteti i Prishtinës, për mësim në gjuhën shqipe, do të pranojë edhe **261** studentë nga pjesëtarët e komuniteteve: boshnjakë, turq, romë, ashkali dhe egjiptianë, sipas fakulteteve:

Nr.	**Fakulteti**	**Boshnjak**	**Turq**	**Romë**	**Ashkali**	**Egjiptian**	**Gjithsejt**
1	Filozofik(Shkenca politike, Psikologji,Sociologji)	7	4	1	3	3	18
2	FSHMN(Fizikë, Kimi, Biologji)	6	4	3	3	3	19
3	i Filologjisë(Gj.L. angleze, GJ.L. gjermane, Gj. shqipe, Letërsi shqipe)	8	4	2	3	3	20
4	Juridik	9	5	2	3	2	21
5	Ekonomik(Financa, banka dhe Menaxhment dhe Informatikë)	12	10	2	2	3	29
6	i Ndërtimtari dhe Arkitekturë	6	10	3	3	3	25
7	i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	5	5	2	2	2	16
8	i Inxhinierisë Mekanike	2	3	2	2	2	11
9	i Mjekësisë(Mjekësi e përgjithshme, Farmaci, Stomatologji,Fizioterapi)	9	3	3	3	3	21
10	i Arteve	3	2	1	1	1	8
11	i Bujqësisë dhe Veterinarisë	4	3	2	2	2	13
13	i Shkencave Sportive	5	3	1	1	1	11
14	i Edukimit	6	2	5	5	2	20
17	FSHTA Mitrovicë	4	2	3	3	3	15
21	FSHTA Ferizaj	5	0	3	3	3	14
	Gjithsej	**91**	**60**	**35**	**39**	**36**	**261**

Vërejtje:

Në tabelën paraqitur me kuotat për nxënësit të cilët e kanë përfunduar mësimin në gjuhën turke dhe boshnjake duhet të merret parasysh gjuha e shkruar në dokumentacionin pedagogjik, dëftesat dhe diploma.

Me përjashtim nga vërejtja e lartpërmendur janë kandidatët nga komunat ku nuk organizohet mësimi në këto dy gjuhë dhe këta kandidatë duhet të paraqesin edhe një vërtetim për përkatësinë etnike të tyre.